

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “REHABILITIMI DHE RIPARIMI I SISTEMIT ENERGIJITIK,
STACIONI 1,6 UZ, KSAMIL, STACIONI “LUGU I DARDHES”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Pajisje
elektrike dhe aksesore, Pajisje elektrike, Sherbime për riparimin dhe mirëmbajtjen e aparateve mates
te energjisë elektrike

**VLERA E FONDIT LIMIT: 4,246,266 (kater milion e dyqind e dyzet e gjashtë mijë e dyqind e
gjashtedhjetë e gjashtë) leke pa tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit
78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të
ndryshuar, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujesjelles-Kanalizime Sarandë Sh.a, ka hartuar
procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim
për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr.
285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të
VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3
(tre) viteve të fundit ushtrimore (2020, 2021 dhe 2022) lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e
xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës
së përlogaritur të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në:

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t’i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29.

2.2.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të bilanceve, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) për vitet 2020, 2021 dhe 2022 ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme përfshirjen e këtij kriteri, në mënyrë që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm në procedure.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, të ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Ne baze të VKM-se nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 55, pika 4/b ku citohet se: "Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës".

2.3.2 Liçencat profesionale që duhet të plotësojnë pjesëmarrësit, në varësi të llojit të punimeve për këtë objekt, do të jetë:

NP-2 klasifikimi A, Ndërtime civile dhe industriale.

N.P – 11, klasifikimi A, (Ndertime për N/stacionet, kab.transformatori, linja e TN te mesem dhe shperndarjen e energjiise)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe VKM nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi". Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome/deshmi përkatëse leshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, deshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) leshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjesve, si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë, si më poshtë;

- 4 (kater) punonjes elektrikist
- 2 (dy) prej ketyre (kategoria III) ose me larte, pjesa tjetër të jenë të pajisur me IQT për elektrikist.
- 1 (një) Ing. Elektrik
- 1 (një) manovrator të pajisur me deshmi aftesi/leje manovrimi profesionale

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

- Numri i fuqisë punëtore u llogaritet duke u bazuar në numrin e personelit të grupit të punës që mund të punojnë për përmbushjen e shërbimit të kërkuar gjatë një periudhe gjatë kontratës, ky numer përkon dhe me kërkesën e personelit në pikat e mësipërme

- Njesia e Prokurimit (specialisti i fushës) vlerëson se të pakten 2 punonjes duhet të jenë pajisur me me kartela personale të sigurimit teknik, të leshuara nga Inspektoriati Qendror Teknik ose nga organi kompetent në bazë të ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001 dhe ligjit Nr.13/2013, datë 14.02.2013, nga të cilët të pakten 10 (dhjetë) të jenë elektrikist dhe me deshmime përkatëse të formimit. Këto deshmie duhet të kërkojnë për shkak të natyrës së shërbimeve, punonjësit duhet të kenë njohuri të plota mbi elektroteknikën, njohuri të plota të Rregullores së Sigurimit Teknik Elektrik, mbi rregullat e përdorimit të mjeteve mbrojtëse që përdoren në linjat elektrike. Gjithashtu të kenë njohuri mbi impiantet elektrike (linjën elektrike), që të jenë të aftë nëpër caktimin, se cilat

elemente duhet të hapen për kryerjen e punimeve, dhe të dijë të veprojë në zbatimin e masave të domosdoshme të sigurimit teknik elektrik.

- Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek oret maksimale të punës që duhen për përmbushje të shërbimit dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën.

- Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përse kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

- Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

2.3.4 Makineri dhe pajisje

Operatori ekonomik duhet të paraqesi makineri dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme;

Nr	Lloji i makinerive	Sasia	Gjendja
1	Kamion me vinc me karrocëri	1	Pronesi ose qera
2	Meganometer 2500-5000V	1	Pronesi ose qera
3	Aparata mates rezistence (Terrameter)	1	Pronesi ose qera
4	Kokore	5	Pronesi
5	Komplet i ndihmes së shpejt	2	Pronesi
6	Tabela paralajmëruese për sigurimin e perimetrit të kantierit	6	Pronesi
7	Set veglash për kabllo TM (prerese kablli, presa hidraulike për kapikorda, bombull gazit me kanello)	2	Pronesi ose qera
8	Jeleke	5	Pronesi
9	Kenotron për kontrollin e kabllave	1	Pronesi ose qera

Për mjetet që shënohen në regjistrin publik, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit:

certifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, sigurancë, taksa vjetore, leja e transportit që leshohet nga njësia vendore dhe fotot përkatëse

Ndërsa për mjetet të marra me qera krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet dhe pajisjet teknike që në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Konkretisht:

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar shërbimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve për përmbushjen e shërbimit, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik

duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas standarteve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Certificate EN-ISO 9001:2015 Sistemet e menaxhimit të cilësive/ ose ekuivalent
- b) Certificate OHSAS 18001-2007 Sistemi i menaxhimit dhe sigurisë në punë / ose ekuivalent
- c) Certificate EN ISO 3834 -2:2006 Kërkesat e cilësisë për saldimit me shkrirje të materialeve metalike / ose ekuivalent

Argumentimi: Në bazë të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, citon: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”

Nj. P vendosi të kërkojë certifikatat e mësipërme për të vërtetuar cilësinë e shërbimeve që do të kryen nga O.E fitues. Certifikatat e kërkuara janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe respektojnë parimin e mosdiskriminimit.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Punimet e përshkruara në preventiv, do të kryhen në Stacionet e Pompimit të Ujërave të Ndotura Ksamil, Stacioni nr.1, Stacioni nr.6. dhe stacioni tek “Lugu i Dardhes”. Më poshtë do të ilustron me fotografi punimet që parashikohet të kryhen:

Demontimi i celave të demtuara



Zëvendësimi



Riparimi i paneleve TU dhe
Zëvendësimi i celave të dëmtuara



Punimet që do të kryen në këto stacione janë:

1. Demontimi i celave TM të dëmtuara në stacionin nr.1 dhe nr.6, dhe zëvendësimi i tyre me ato të reja, konform kriterëve të përcaktuara në Specifikimet Teknike.
2. Inspektimi i stacionit, pastrimi i transformatorit, kabllave, inverterave dhe cdo pjesë apo pajisje tjetër të instaluar në stacionin nr.6 që janë dëmtuar si pasojë e problemit të ndodhur datë 06.04.2023
3. Përgatitja e kokave të reja të kabllave 20kV ku lidhen celat e linjave (hyrje-dalje) dhe cila e transformatorit.
4. Instalimi dhe riparimi i panelit kryesor TU që furnizon të gjitha pajisjet e instaluar në këtë stacion (celsi rrjet-gjenerator dhe automatet e tjerë), të përcaktuara në Specifikimet Teknike.
5. Zëvendësimi i kabllave të fuqisë dhe komandimit të elektromotorëve që janë dëmtuar në stacionin nr.6. Do të kihet parasysh që gjatë zëvendësimit të kabllave, duhet të jetë në gjendje pune të paktën një nga elektropompat e stacionit.

6. Riparimi i sistemit të ndricimit dhe sistemit të fuqisë në stacion, pastrimi i panelit TM të matjes të energjisë, pastrimi dyshemesë dhe lyejra e mureve me bojë të bardhë e stacionit nr.6

7. Transportimi i të gjitha pjesëve të dëmtuara në magazinën qendrore (Vrion) të Ujësjetës Kanalizime Sarandë, dhe heqja e të gjitha mbetjeve nga stacioni në përfundim të punimeve.

Do të kthehet parasysh që përpara fillimit të punimeve Autoriteti Kontraktor duhet të njoftojë dhe të rakordojë me OSHE për kohën e stakimit të energjisë elektrike në zonën ku do të kryhen këto punime. Për natyrën e punimeve është e domosdoshme edhe pjesëmarrja e specialistëve të OSHE, për shkak të ndjekjes së rregullave të sigurimit teknik (sipas rregullores së OSHE). Gjithashtu, meqenëse parashikohet ndërprerja e energjisë elektrike për disa orë, për të kryer punimet e nevojshme në këto stacione, Autoriteti Kontraktor duhet të sigurojë furnizimin me energji elektrike nga gjeneratorët e stacioneve, duke lënë të pakten një nga elektropompat në gjendje pune. Të merren masat e nevojshme të sigurimit teknik sipas rregulloreve në fuqi.

Specifikimet Teknike Cila të Tensionit të Mesëm 20KV, 630A

1. Specifikime të përgjithshme

Cila e linjes me ndares ngarkese me gaz SF6

Cila përmban ndaresin me gaz SF6, thikën e tokëzimit, përcjellesit dhe zbarat lidhëse; zbarat e daljes së TM të sheshta të përshtatshme për lidhjen e kapikordes të kabllave një dejes.

Cila e transformatorit me ndares ngarkese me gaz SF6 dhe siguresë.

Cila përmban ndaresin e ngarkesës me izolacion me gaz SF6, thikën e tokëzimit, siguresat, përcjellesit dhe zbarat lidhëse; zbarat e daljes së TM të sheshta të përshtatshme për lidhjen e kapikordes të kabllave një dejes.

Sherbime të nevojshme

Furnizuesi duhet të sigurojë shërbimet e mëposhtme:

- Furnizimin e paisjeve të kërkuara për montimin ose mirëmbajtjen e materialeve të furnizuara;
- Furnizimin e manualeve të përdorimit dhe mirëmbajtjes dhe dokumenta të tjera të specifikuar në Specifikime Teknike.

Të përgjithshme

Furnizuesi duhet të paraqesë të blerësi:

Vizatimet, të dhënat e projektimit, përkrahjet e paisjeve, llogaritjet, raportet e testeve, instruksionet e instalimit dhe të mirëmbajtjes.

2. Specifikime teknike të detajuara

2.1 Të përgjithshme

Ky specifikim përmban Specifikimet Teknike të Përgjithshme për projektimin, prodhimin, testimin e paisjeve për përdorim të brendshëm me lidhje kablli nga poshtë si dhe furnizimin e paisjes.

Kërkesat specifike për tu aplikuar në paisje të ndryshme duhet të përmbushin Standartet IEC publikimet e fundit ose ekuivalentet e tyre.

Cilat 20 kV do të përdoren në rrjetin e shpërndarjes. Vetëm materialet me cilësi të lartë do të furnizohen.

Këto paisje do të montohen në Stacionet e Transformimit (kabinat) 20/0.4 kV dhe duhet të sigurohen me një pllakate (targete) në përputhje me standartet IEC.

Të gjitha paisjet duhet të ndërtohen sipas kërkesave:

- Të jete në gjendje të duroje të gjitha kushtet e ngarkesës dhe tensionit.
- E përshtatshme për instalim të brendshëm në kushte klimatike si me poshtë të përmendura.
- Lehtësisht e zëvendësueshme
- Të kenë markim CE

Kushtet e sistemit:

Specifikime	Njesia	Sistemi 20 kV
Te dhena per sistemin	+	
Tensioni me I larte I sistemit	kV	24
Tensioni nominal	kV	20
Frekuenca	Hz	50
Numri I fazeve	No.	3
Sistemi I tokezimit	-	I izoluar
Lloji I nenstacionit		I brendshem
Rryma e lidhjes shkurter 1 sek	kA	20

Kushtet atmosferike:

Temperatura maksimale e ambientit	40 °C
Temperature minimale e ambientit	- 10 °C
Temperatura mesatare maksimale ditore	30 °C
Lageshtia relative maksimale	%
Lartesia maksimale mbi nivelin e detit	1000 m

2.2 Cela 20 kV tip modul (cubicle)

Cela e linjes hyrese/dalese me ndares ngarkese me gaz SF6 dhe cela e mbrojtjes te trasformatorit me ndares ngarkese me gaz SF6 dhe siguresa TM

2.2.1 Pershkrime, kerkesa dhe te dhena

Te gjitha paisjet e kesaj pjese do te montohen ne boks metalik :

- Cela e linjes me ndares ngarkese me gaz SF6 permban ndaresin e ngarkeses me gaz SF6, thiken e tokezimit, percjellesit dhe zbarat lidhese; zbarat e daljes se TM te sheshta te pershtateshme per lidhjen e kapikordes te kablllove nje dejesh.
- Cela e trasformatorit me ndares ngarkese me gaz SF6 dhe siguresa.
Cela permban ndaresin e ngarkeses me gaz SF6, thiken e tokezimit, siguresat, percjellesit dhe zbarat lidhese; zbarat e daljes se TM te sheshta te pershtateshme per lidhjen e kapikordes te kablllove nje dejesh

2.2.2 Cele linje me ndares ngarkese me SF6 (panel ëith SF6 load sëitch disconnecter)

Te dhena teknike:

<u>Tensioni me I larte I sistemit</u>	kV	24
<u>Vlera e tensionit nominal</u>	kV	20
<u>Rryma nominale ne zbare</u>	A	630
<u>Rryma nominale ne fider</u>	A	630
<u>Rryma nominale ne lidhje te shkurter (1 sec.)</u>	kA	20
<u>Vlera e tensionit impulsiv te qendrueshmerise ndaj shkarkimeve</u>	kV	125
<u>Vlera e tensionit te qendrueshmerise per frekuencen 50 Hz</u>	kV	50
<u>Shkalla e mbrojtjes</u>		IP 3X

Ndertimi dhe materiali

Paneli do të ketë një shkallë mbrojtjeje të përgjithshme IP 3X. Të gjitha pjesët e çelikut do të trajtohen me proces pastrimi, heqjeje të grasos dhe fosfatimi.

Pjesët perberese do të ndërtohen me fletë çeliku të galvanizuar dhe të perforcuar, që të jenë të sigurta dhe të mos deformohen edhe në kushtet më të vështira të punës.

Në pjesën fundore paneli duhet të pajiset me korniza për tu fiksuar në dyshtemenë prej betoni.

Panelet do të pajisen me dritare në pjesën e përparme për të monitoruar pozicionin e kontakteve të ndaresit të ngarkesës dhe thikës së tokës si dhe çdo të dhënë të rëndësishme.

Siguria e personelit do të garantohet me kycje të thjeshtë manuale që parandalon çdo mundësi përdorimi të gabuar. Dera është e nderthurur me bllokim mekanik me thikën e tokës.

Klasifikimi i Harkut të brendshëm do të jetë IAC AFLR 12.5 kA 1sekond. Përshkrimi i mbrojtjes si standarti ndërkombëtar.

Klasa e operimit LSC2A

Sistemi i zbarave do të montohet në ndarjen e duhur të panelit, në mënyrë që të bëhet e mundur lidhja e duhur e të gjitha pajisjeve ndërmjet terminaleve të kabllave hyrës dhe dalës.

Sistemi i zbarave do të dimensionohet, rregullohet dhe të fiksohet në atë mënyrë që t'i rezistojë dinamikës së pikut të rrymës të lidhjes të shkurtër, pa transmetuar tension shtesë në izolatorët dhe pjesët e tjera të panelit.

Indikatorët e tensionit për çdo fazë, duhet të jenë tregues kapacitive.

Cela duhet të ketë një tregues me ngjyra ku ngjyra jeshile tregojë se paisja është në gjendje për të operuar dhe ngjyra e kuqe tregojë se paisja nuk duhet të operojë.

Dyert e panelit duhet të jenë paisura me sistem bllokazhi me qellim që të mos hapen pa u marrë të gjitha masat e sigurisë si heqje tensioni, tokezim etj.

Çdo panel do të jetë i llojit vetë mbështetës, i pa integruar (i veçuar), që të ofrojë lehtësisht akses për punë, inspektim dhe mirëmbajtje nga ana balllore.

Të gjitha materialet për të fiksuar panelin në dyshtemenë prej betoni do të konsiderohen si të përfshira në furnizim.

Paneli duhet të ofrojë mundësi zgjerimi në të dy krahët dhe të përshatet në lidhje edhe me tipet e moduleve egzistuese.

Ndaresit do të jenë të llojit “me veprim të shpejtë” (süste me mekanizëm karikimi) me pjesë të dimensionuara lirshëm.

Komutimi i ndaresit të ngarkesës bëhet në mënyrë manuale. Pjesë e furnizimit do të jetë edhe leva për manovrimin e ndaresit dhe thikës së tokës.

Ndaresi duhet të jetë me tre pozicione.

Për arsye sigurie, duhet një indikator tregues për pozicionin e ndaresit të ngarkesës dhe thikës së tokëzimit. Ndaresi i ngarkesës dhe thika e tokezimit kanë bllokim mekanik midis tyre.

2.2.3 Cele transformatori (cubicle) me ndares ngarkese me SF6 dhe sigurese (panel ëith SF6 load sëitch disconnector and fuses)

Pershkrim, Kerkesa dhe te Dhena:

Ky specifikim mbulon kerkesat per celat TM me ndares ngarkese dhe sigurese.

Ndaresi i ngarkeses, duhet te perballoje dhe nderprese çdo rrymë nga zero deri në rrymën nominale te tensionit të mesëm te sistemit (20 kV)

Te dhena teknike:

Nr	Lloji	Celesi I ngarkeses	
		trepolar	
	Tensioni me I larte I sistemit	kV	24
	Tensioni nominal	kV	20
3	Rryma nominale ne zbare	A	630
4	Rryma nominale e ndaresit (I_n)	A	200
5	Frekuenca	Hz	50
6	Rryma qe duron ne qark te shkurter per 1 sec.	kA	20
7	Vlera e tensionit impulsiv te qendrueshmerise ndaj shkarkimeve	kV	125
8	Vlera e tensionit te qendrueshmerise per frekuencen 50 Hz	kV	50

Ndertimi dhe materiali

Paneli do të ketë një shkallë mbrojtjeje të përgjithshme IP 3X.

Të gjitha pjeset e çelikut do të trajtohen me proces pastrimi, heqjeje të grasos dhe fosfatimi.

Pjeset perberese do të ndërtohen me fletë çeliku te galvanizuar dhe te perforcuar, që të jenë të sigurta dhe të mos deformohen edhe në kushtet më të vështira të punes.

Në pjesen fundore paneli duhet te pajiset me korniza për tu fiksuar në dyshtemenë prej betoni.

Panelet do të pajisen me dritare ne pjesen e perparme për të monitoruar pozicionin e kontakteve te ndaresit te ngarkesës dhe thikës se tokës si dhe çdo të dhënë të rëndësishme.

Siguria e personelit do të garantohet me kycje të thjeshtë manuale që parandalon çdo mundësi përdorimi të gabuar. Dera eshte e nderthurur me bllokim mekanik me thiken e tokes.

Klasifikimi i Harkut te brendshem do te jete IAC AFLR 12.5 kA 1sekond. Pershkrimi i mbrojtjes si standartit nderkombetar.

Klasa e operimit LSC2A

Sistemi i zbarave do të montohet në ndarjen e duhur te panelit, në mënyrë që të bëhet e mundur lidhja e duhur e të gjitha pajisjeve ndërmjet terminaleve te kablllove hyrës dhe dalës.

Sistemi i zbarave do të dimensionohet, rregullohet dhe të fiksohet në atë mënyrë që t'i rezistojë dinamikës së pikut të rrymës te lidhjes të shkurtër, pa transmetuar tension shtesë ne izolatorët dhe pje sët e tjera të panelit.

Indikatorët e tensionit për çdo faze, duhet te jene tregues kapacitive.

Cela duhet te kete nje tregues me ngjyra ku ngjyra jeshile te tregojë se paisja eshte ne gjendje per te operuar dhe ngjyra e kuqe te tregojë se paisja nuk duhet te operojë.

Paneli metalik duhet te jete me etiketë(targete), në përputhje me Standardin IEC 298.

Dyert e panelit duhet te jene paisura me sistem bllokazhi me qellim qe te mos hapen pa u mare te gjitha masat e sigurise si heqje tensioni, tokezim e tje.

Çdo panel do të jetë i llojit vetë mbështetës, i pa integruar (i veçuar), që të ofrojë lehtësisht akses për punë, inspektim dhe mirëmbajtje nga ana ballore.

Të gjitha materialet për të fiksuar panelin në dyshtemenë prej betoni do të konsiderohen si të përfshira në furnizim.

Paneli duhet te ofroje mundesi zgjerimi ne te dy krahët dhe te pershtatet ne lidhje edhe me tipet e moduleve egzistuese.

Ndaresit do të jenë të llojit “me veprim te shpejte” (suste me mekanizem karikimi) me pjesë të dimensionuara lirshëm.

Komutimi i ndaresit te ngarkeses behet ne menyre manuale. Pjese e furnizimit do te jete edhe leva per manovrimin e ndaresit dhe thikes se tokes.

Ndaresi duhet te jete me tre pozicione.

Për arsye sigurie, duhet një indikator tregues per pozicionin e ndaresit te ngarkesës dhe thikes se tokëzimit.

Ndaresi i ngarkeses dhe thika e tokëzimit kane bllokim mekanik midis tyre.

Djegja e sigureses duhet te shoqerohet me stakimin e ndaresit.

Siguresat TM

Ky specifikim mbulon kërkesat e siguresave TM, të përshtatshme për instalime të brendshme

Ndertimi dhe materiali

Siguresat TM do të kenë aftësinë të mbrojnë transformatorin e fuqisë nga rrymat e lidhjes se shkurter.

Siguresat TM do të kenë ndërtim te tille që të përmbushin kërkesat e mëposhtme:

Qendrushmeri ndaj te mjaftueshme te rrymave ne lidhje të shkurtër.

Qendrushmeri te mjaftueshme ndaj kushteve të ambientit

Pjeset perberese te sigureses të mos vjeterohen shpejt.

Të bëhet e mundur ndërrimi i tyre me siguresa të prodhuara sipas nje standarti nderkombetarFisheku do të prodhohet prej porcelani cilësor me sipërfaqe të shkëlqyeshme.

Të dyja pjeset e kontaktit te fishekut(xokolat), e poshtmjaja edhe e sipërmjaja, do të realizohen me material bakri elektrolitit i mbrojtur galvanikisht, te rotulluara ne kanal in e tubit te sigureses ne menyre hermetike. Kjo eshte shume e rendesishme sepse hermetizimi i ketij bashkimi eshte rezistent ndaj konsumit(vjeterimit) dhe temperaturave te larta.


Komponent shume i rendesishem i siguresave TM eshte elementi shkrires , percjellesat ose shiritat duhet te jene argjend i paster. Preferohet te kete sa me shume elemente shkrires te lidhur ne paralel , me qellim qe te arrihet trashesi sa me vogel e tyre.

Siguresa do te lidhet me nje paisje sinjalizuese, e cila do te jap informacion mbi gjendjen e sigureses apo mekanizmave te tjere si p.sh ndaresin e ngarkeses.

Djegja e sigureses duhet te shoqerohet me stakimin e ndaresit.Izolatorët mbështetës të bazamentit duhet të prodhohen prej porcelani ose epoxy material.

Fashetat (fiksuesit) , te cilat bejne kontaktin elektrik me xokolat e sigureses duhet te realizohen me baker elektrolitik te zinkuar, fashetat duhet te kene elasticitet te larte mekanik me qellim qe te sigurojne vlere te vogel te rezistences se kontaktit.

Skema:



1.Cele Tensioni Mesem te 24 kV, 630 A

<i>Tipi</i>	<i>Cela 3-fazore Miniblokk</i>
<i>Tensioni maksimal</i>	<i>kV 24</i>
<i>Rryma nominale (In)</i>	<i>630 A</i>
<i>Qendrueshmeria kundrejt impulsit atmosferik</i>	<i>50/125 kV</i>
<i>Rryma e punes ne kohe te shkurter</i>	<i>20 kA</i>
<i>Pesha</i>	<i>≤ 150 kg</i>
<i>Celesi i ngarkeses</i>	
<i>Rryma nominale (In)</i>	<i>630 A</i>
<i>Rryma e punes ne kohe te shkurter</i>	<i>20 kA</i>
<i>Rryma e lidhjes ne te shkurter</i>	<i>40 kA</i>
<i>Celesi i tokezimit</i>	
<i>Rryma e punes ne kohe te shkurter</i>	<i>20 kA</i>
<i>Rryma e lidhjes ne te shkurter</i>	<i>40 kA</i>
<i>Numri i lidhejve ne te shkurter</i>	<i>5</i>
<i>Permasat</i>	
<i>Lartesia</i>	<i>1850 mm</i>
<i>Gjeresia</i>	<i>500 mm</i>
<i>Thellesia</i>	<i>1050 mm</i>

Tabela dhe figura ilustruse:




Dimensioni e pesi

Overall dimensions and weights

SIGLA TYPE	TERMINAZIONE CAVO CABLE TERMINATION	Largh Width L	Alt Height H	Prof Depth P	Peso Weight Kg.
CA6	Standard	500/375	1850	1050	100/80
CAT6	Standard	500	1850	1050	120
RCV6	Standard	200/300	1850	1050	50
SFSG6	Ridotta/Short termination	500	1850	1050	170
SC6	Standard	500	1850	1050	155
MS6	/	500	1850	1050	270
ISF6	Standard	750	1850	1050	470
SINT6	Standard	500	1850	1050	265
ISFR6	/	750	1850	1050	480
SINTR6	Standard	875	1850	1050	300
SIF6-750	Ridotta/Short termination	750	1850	1050	470
SIF6	Ridotta/Short termination	500	1850	1050	265
ISFRD6	/	750	1850	1050	530

Technical characteristics

Minibloc-6 type switchboard		
Rated voltage	Ur (kV)	24kv
Test voltage (50-60 Hz/1 min)	Ud (I min) (kV)	28-38-50
Impulse withstand voltage	Up (kV)	75-95-125
Rated frequency	Fr (Hz)	50
Main busbars rated current	Ir (A)	630A
Load break switch rated thermal current	Ir (A)	400 - 630
Rated thermal current for disconnecter	Ir (A)	400 - 630-1250
Allowable rated short-time current (1s)	Ik (kA)	20
Peak current	Ip (kA)	31,5 - 40 - 50 - 62,5
Internal arc withstand current at 24 kV :		
- Basic range IAC AF 0,5 sec	(kA)	12,5
- On demand IAC AFLR 1 sec	(kA)	20
Outside enclosure protection degree	IP	30
Inside protection degree	IP	20



Specifikime Teknike Paneli Nevojave Vetjake

Paneli TU i shperndarjes do te jete i perbere nga keto komponente:

1. Mbrojtje prezence rrjeti, mbrojtje rrjeti, mbrojtje gjenerator, mbrojtje multimetri
2. Multimeter dixhital, tregues nivel tensioni
3. Shkarkues
4. Celes automatik/manual gjenerator- rrjet
 $I_n = 1000 A$
 $U_e = 690V$
 $U_i = 1000 V$
 $U_{max} = 8 kV$
5. Automat magneto-termik per Pompat
Numri i poleve 4P,
Rrymat nominal $I_n =$
Tensioni $U_n = 380-500V,$
 $I_d = 5kA$
6. Automat magneto-termik per Vincin
Numri i poleve 4P,
Rrymat nominal $I_n = 60A$
Tensioni $U_n = 380-500V,$
 $I_d = 5Ka$
7. Automat magneto-termik Ndricimi
Numri i poleve 1P,
Rrymat nominal $I_n = 16A$
8. Automat magneto-termik Fuqia
Numri i poleve 1P,
Rrymat nominal $I_n = 25A$

SPECIFIKIME KOKA (TERMINALE) KABLLI TM

Te pergjithshme

Te gjitha terminalet e kabllit 20 kV jane projektuar qe te jene te sigurta ne kushte klimatike te ndryshme pa pesuar demtime.

Terminalet e kabllit 20 kV duhet te jene te sigurta edhe kur jane ne ngarkese , nen tension apo nen veprimin e lidhjes se shkurter apo avarive te tjera qe mund te ndodhin ne sistem, ato duhet te sigurojne dhe punojne ne kushte optimale.

Kerkesa te detyrueshme

Eshte e detyrueshme qe furnizuesi te siguroje:

Certifikatat e prodhuesit ISO 9001
Te dhena teknike si ne specifikime teknike
Te gjitha test raportet e fabrikes
Skicat dhe dimensionet
Manual I perdorimit
Te kene marketim CE

Kushtet e sistemit

Te dhena per sistemin

Specifikime	Njesia	
Tensioni nominal ne sistem	kV	20
Tensioni me i larte per paisjet	kV	24
Frekuenca e sistemit	Hz	50
Numri I fazeve		3
Sistemi I tokezimit		izoluar


Kushtet atmosferike

Temperature maksimale e ambientit	40 °C
Temperatura maks. <u>mesatare</u> ditore	30 °C
Temperatura minimale e ambientit	-10 °C
Temperatura maks. <u>ne</u> siperfaqet e ekspozuara ne diell	60 °C
Lageshtia relative maks (<u>ne</u> toke)	%
Lageshtia relative maks (<u>ne</u> ajer)	%
Lartesia maksimale mbi nivelin e detit	<1000 m

Terminale te brendeshem 20 kV

Ilustrim

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



Pershkrim

Keto specifikime ju perkasin kerkesave per terminale (te termotkurrshe) te brendshme per kablot 1-dejesh te ekranuar XLPE alumini 20 kV.

Trupi I terminalit(I termotkurrshe) duhet te kete nje shtrese kontrolli per te kryer kontrollin e fushes elektrike brenda te gjithe gjatesise se terminalit dhe nje shtrese izolimi ne formen e nje tubi me dy shtresa te stampuara qe ne prodhim per te mos lejuar fluska ajri midis tyre, qe ben te mundur mospasjen e zonave me gradiente te larte te fushes elektrike. Ngjitesin termoshkrires me shkrirjen e tij hermetizon skajet e kablrit nga lageshtira dhe papastertite.

Materiali nuk duhet te jete I levizshem, duhet te jete rezistent ndaj erozionit dhe rrezeve ultraviolet.

Hermetizimi I plote I kablrit , rrjetes prej bakri realizohet nepermjet perdorimit te mastikes se termotshkrishme ne te dy anet e terminalit. Ngjitesi I termoshkrishem I tubit te jashtem shkrin gjate instalimit dhe dhe mbush porete e kablrit duke u ngjitur me te dhe duke krijuar hermetizim te larte ndaj lageshtise, papastertive etj.

Ai gjithashtu permban nje shirit ne ngjyre te verdhe, i cili mbeshillet perreth “shtreses gjysem percjellese izoluese”, per te siguruar mos shkarkimin ne kete zone si rezultat i hapesirave me ajer.

Kapikordat ne forme syri duhet te jene prej materiali bimetalik (Al-Cu) dhe te jene brenda kompletit. Me kerkese te vecante ku percaktohet dhe materiali Cu-Al ose Al, kapikordat mund te jene edhe ne forme kunji,

Bshkueset per lidhjen me token do te porositen te ndara.

Seti I terminaleve te furnizuara duhet te perfshije materialet komplet per gjithe kabllin nje fazor.



Perdorimi

Terminalet e brendeshme jane ndertuar per kabllot e ekranizuar me nje dell me izolim plastic 20 kV dhe perdoren per ambiente te brendeshme.

Te dhena teknike per koka kablli 1x----- per ambient te brendshem

Lloji	Vlera e tensionit (kV)	Seksioni terthor I percjellesit te fazes (mm ²)	L (mm)	Seksioni terthor I percjellesit te fazes (mm ²)	L (mm)
I	20	25-70	300	50 - 150	340
II		70 - 240	300	120 - 240	340
III		185 - 400	300	185 - 300	340
IV		400-800	340	400-630	340

SKEMA ELETRIKE E STACIONIT NR.1 DHE NR.6



Më pas u vendos për këto çështje:

Vlefshmëria e ofertës 150 ditë.

Kriteret e vlerësimit: Është çmimi më i ulët i ofruar.

Afatet e ekzekutimit, janë 1 muaj, ose 30 dite, nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes kuadër.

Komisioni unanimisht bëri miratimin e tyre dhe u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave, në Sistemin Elektronik.

NJESIA E PROKURIMIT

ANILA VJERI

ALGERT BAJRAMI

LILJANA GJATI

